



Duke u bazuar në nenin 43, 45 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Nr.03/L-040, nenin 47 të Statutit të Komunës së Klinës Nr. 01-110-1232/2010. Nenin 5 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës si dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bën këtë:

F T E S Ë

Ftohën të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe të interesuarit e tjerë që të marrin pjesë në seancën e **IV-të të rregullt të punës së kuvendit për vitin 2026.**

Seanca mbahet më **24.04.2026 (e Premte)**, në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe fillon në orën **10:00.**

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së. Për këtë seancë propozohet ky:

R E N D I I D I T Ë S

1. Arsyetimi i mungesave;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë 27.03.2026;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të KPF-së nga mbledhja e mbajtur më datë 10.04.2026;
4. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar–mars 2026 (ref. ekz.);
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në ndërmarrjen KRM “Ambienti” në Pejë (ref. ekz.);
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për zëvendësimin e anëtarit të KKSBS-së;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për themelimin e komiteteve të tjera ;
 - Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
 - Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport;
 - Komiteti për Planifikim Urban, Ekonomi dhe Zhvillim;
 - Komiteti për Shërbime Publike;
 - Komiteti për Pronë;
8. Pyetje dhe përgjigje.

01Nr. 06-10388 2026
Klinë, me 14.04 2026



Kryesuesi i Kuvendit,
Enver Berisha